



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br. 67 / 14

Nr. i fq. / Br. sh. - 17 -

Data: / Datum 27.03.2014

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
Nga mbledhja e II-të e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë,
mbajtur më 27.02.2014

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit komunal, duke filluar në orën 10:10. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Agim Bregaj, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatime Haziri, Habib Mustafa, Habibe Gërxhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Ismet Gashi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mirjeta Salihu, Mentor Ferizi, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rustemi, Selvete Sholla, Syzana Syla, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani, dhe Zoran Rakiç.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: nënkryetari i komunës, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – për në “të ndryshme” propozoi të futen dy pika: a. Shqyrtimi i propozimeve për delegatët, për Kuvendin Zgjedhor të Asociacionit të Komunave të Kosovës; b. Shqyrtimi i propozimeve të AAK-së për dy komitetet obligative.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit - tha se Grupi kuvendar i LDK-së, për “të ndryshme” propozon të futet propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale, për të hequr taksën në firmë, për bizneset që operojnë në Komunën e Vushtrrisë, duke shtuar se taksa aktuale ligjërish nuk është taksë, sepse taksat dhe tarifat, qytetarët i paguajnë kur shkojnë të kërkojnë një shërbim nga organet komunale, prandaj kjo më tepër është gjobë për bizneset sesa taksë.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – duke iu referuar propozimit të I.Gashit, tha se të gjithë pajtohemi që të hiqet taksa në firmë, mirëpo është një dokument që kërkon kohë për t’u përgatitur dhe duhet të kalojë për trajtim edhe përmes KPF-së, prandaj kërkoi që propozimi në fjalë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme të KK-së.

Idriz Muzaqi, përgjegjës i Zyrës Ligjore - sqaroi se në planin buxhetor për vitin 2014 është paraparë pozicioni taksa në firmë, prandaj nëse kjo çështje ndryshohet në këtë vit, atëherë Kuvendi i komunës do të vijë në kundërshtim me vendimin e KK-së që është aprovuar Plani buxhetor për vitin 2014, dhe shtoi se kjo çështje mund të diskutohet dhe planifikohet për vitin 2015.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - kërkoi nga Sekretaria e kuvendit që forma e dërgimit të materialit të jetë e ngjashme për të gjithë anëtarët e kuvendit, kurse sa i përket propozimit për heqjen e taksës në firmë, tha se grupi kuvendar ka diskutuar edhe më herët për këtë çështje dhe pajtohet që të hiqet taksa në firmë, por pasi që Planifikimi buxhetor për vitin 2014 nuk e mundëson, atëherë kërkoi që ky propozim të shtyhet për 6-mujorin e dytë të vitit 2014.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit - tha se janë të vetëdijshëm që heqja e taksës në firmë ka implikime edhe në buxhetin komunal, të cilat kanë qenë të parapara me vendimin për aprovimin e buxhetit komunal, mirëpo kur është në pyetje interesi i krijimit të kushteve dhe lehtësirave për bizneset e komunës tonë, atëherë ka mundësi që kjo pjesë të mbulohet me të hyrat nga tatimi në pronë, duke shtuar se ka biznese që kanë të papaguar tatim në pronë rreth 4.000 apo 5.000 €. Në fund tha se shumë komuna e kanë hequr taksën në firmë, tha shtoi se taksa në firmë është një relik i sistemit të kaluar, dhe u pajtua me propozimin e kryesuesit të Kuvendit të komunës, që kjo çështje të shtyhet për mbledhjen e ardhshme të KK-së.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - tha se Grupi kuvendar i AAK-së pajtohet që propozim-vendimi për heqjen e taksës në firmë të shqyrtohet në mbledhjen e ardhshme të KK-së. Pastaj tha se shumë komuna kanë marrë vendim për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për personat e vdekur, prandaj duhet të bëhet një llogari së bashku me Bashkësinë Islame dhe drejtoritë përkatëse për të marrë një vendim të tillë edhe nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë. Mandej ngriti çështjen e funksionimit të fabrikës së "Llamkosit", sepse punëtorët e kësaj fabrike po ballafaqohen prej shumë kohësh me probleme të ndryshme, prandaj kërkoi që Kuvendi i komunës të shpreh interesimin dhe t'ju dalë në ndihmë punëtorëve në fjalë për kërkesat e tyre që janë të ligjshme, dhe për këtë arsye kërkoi të përgatitet informatë për çështjen në fjalë, në njërin nga mbledhjet vijuese të KK-së.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit - duke iu referuar propozimeve të M. Shabanit, tha se në vitin e kaluar është aprovuar Rregullorja për çështjet e varrimit, kurse sa i përket "Llamkosit" dihet që nuk është kompetencë e Kuvendit të komunës, të përzihet në prona private, duke shtuar se Kuvendi i komunës mundet t'ju jep vetëm ndihmë morale.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, kuvendi me vota unanime miratoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake KK-së.
2. Shqyrtimi i Informatës mbi gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë.
3. Shqyrtimi i Informatës për pasqyrat financiare të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2013 (Drejtoria për Buxhet dhe Financa).
4. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë 2013/2014 (Drejtoria për Arsim).
5. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për përcaktimin e kritereve për sigurimin e strehimit për kategoritë sociale – shqyrtimi i parë (Drejtoria për Shëndetësi).
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale (Drejtoria për Shëndetësi).
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e subvencioneve për klubet sportive (Drejtoria për Kulturë).
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale (Drejtoria për Kulturë).

9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shfuqizim të Rregullores për procedurat e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale (Zyra Ligjore).

10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale (Zyra Ligjore).

11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit për ankesa, lidhur me dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale (Zyra Ligjore).

12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin e Vendimit Nr. 25/14, dt. 30.01.2014.

13. Të ndryshme:

a. Shqyrtimi i propozimeve për delegatët për Kuvendin Zgjedhor të Asociacionit të Komunave të Kosovës;

b. Shqyrtimi i propozimeve të AAK-së për dy komitetet obligative;

c. Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake KK-së.

Aprovohet unanimisht procesverbali në fjalë, pa vërejtje dhe sugjerime.

2. Shqyrtimi i Informatës mbi gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë.

Besart Shaqiri, komandant në Stacionin e policisë në Vushtrri - paraqiti sqarime hyrëse lidhur me informatën në fjalë.

Dibran Përçuku, nënkryetar i komunës - lidhur me informatën në fjalë, tha se institucionet komunale kanë një bashkëpunim të shkëlqyeshëm me Stacionin e policisë në Vushtrri. Pastaj pyeti cilat janë arsyet e reduktimit prej 30 policëve në Komunën e Vushtrrisë, si dhe a janë me kohë të caktuar në shërbimin e tyre atje?

Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit - kërkoi raportim për gjendjen e sigurisë në shkolla për vitin 2013 dhe planin operacional për vitin 2014, si dhe pyeti se a ka statistikë policia për numrin e narkomanëve në Komunën e Vushtrrisë.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - në fillim ngriti çështjen e sigurisë nëpër shkolla, pasi që çdo ditë në mediat elektronike dhe të shkruara flitet për një gjendje të keqe të sigurisë në shkolla, duke shtuar se këto probleme nuk janë vetëm çështje të shkollave, por janë probleme shoqërore, duke përfshirë edhe familjen, policinë dhe të gjitha segmentet tjera. Pastaj tha se siguria e përgjithshme si komponentë nuk është vetëm përgjegjësi e policisë, por është përgjegjësi më e gjerë. Po ashtu pyeti se si është veprimi i policëve në komunitete (bashkësi), pasi që policia duhet të jetë e afërt me popullatën për të gjitha problemet e tyre dhe pyeti pse gjithë ai dërgim aq i madh i policëve (në vitin e kaluar) nga Stacioni policor në Vushtrri për të ruajtur ambasada, dhe shtoi se numri prej 30 policëve a duhet të kthehen në Stacionin policor në Vushtrri apo të mbesin atje. Në vazhdim pyeti për prezencën e policisë tek zyrat e KEDS-it, duke shtuar se a mund të jetë pa uniformë policia tek ato zyra. Në fund tha se është shqetësuese që kohëve të fundit është paraqitur me të madhe dukuria e vjedhjeve kundër pronës, prandaj kërkoi që të merren masa për sigurinë e pronës së qytetarëve.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit - lidhur me gjendjen e sigurisë në vitet 2012-2013 në Komunën e Vushtrrisë, tha se në vitin 2012 kanë qenë 1425 raste të veprave penale të ndryshme, nga të cilat janë zbuluar 702 raste, ndërsa kanë mbetur të pazbuluara 723 raste, kurse në vitin 2013 shihet se ka një rënie të konsideruar të rasteve që janë paraqitur, gjithsej 1369, nga të cilat janë zbuluar 729 raste, ndërsa të pazbuluara janë 590 raste dhe shtoi se nga e gjithë kjo nënkuptohet se Stacioni policor në Vushtrri ka pasur një angazhim të madh krahasuar me vitin 2012. Në fund tha se Kuvendi i Komunës

së Vushtrrisë e ka për obligim që të mbështesë Policinë e Kosovës, dhe në veçanti Stacionin policor në Vushtri.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit - falënderoi policinë për bashkëpunimin e shkëlqyer për sigurinë në shkolla. Pastaj kërkoi që edhe në të ardhmen të hartohen plane të përbashkëta veprimi për marrjen e masave preventive që të mos keqpërdoren objektet shkollore nga nxënësit. Në vazhdim njoftoi e në mesin e 6 narkomanëve në Komunën e Vushtrrisë, ka edhe nxënës të shkollës së mesme, prandaj kërkoi që të merren masa parandaluese.

Besart Shaqiri, komandant në Stacionin e Policisë në Vushtri - duke iu referuar pyetjeve të anëtarëve të kuvendit lidhur me informatën në fjalë, u përgjigj me sa vijon: në bazë të strukturës zyrtare të aprovuar në nivel të Policisë së Kosovës, stacioni policor i takon kategorisë B, dhe me strukturë parashihet që të ketë më shumë se 117 zyrtarë të uniformuar policor dhe staf civil, prandaj ai numër i policëve është transferuar në cilësinë e tepricës; me vite të tëra policia është duke u angazhuar për një siguri të plotë, jetën, mirëqenien e personelit dhe të nxënësve në shkolla, dhe në çdo fillim të vitit shkollor janë të angazhuar dy policë që operojnë me rroba civile, ku të njëjtit janë në kontakt me drejtorë të shkollave dhe me kujdestarët e klasave, dhe shtoi se në favor të një sigurie më të madhe, policia ka inspektuar linjat e transportit publik. Po ashtu instalimi i kamerave nëpër shkolla është veprim pozitiv, mandej si veprim negativ e konsideroi organizimin e ekskursioneve në Shqipëri në fillim të vitit shkollor; çështja e përdorimit të substancave narkotike nuk trajtohet në nivel të stacionit policor, por trajtohet në nivel të drejtorisë regjionale dhe drejtorisë së përgjithshme, prandaj Stacioni policor në Vushtri nuk ka numër të saktë të narkomanëve në Komunën e Vushtrrisë; Stacioni i policisë në Vushtri e mban primatin e bashkëpunimit të policisë me komunitetet në bashkësi; është një marrëveshje që është arritur në nivel të Kosovës në mes të drejtorit të KEDS-it dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, ku policët kujdestarojnë me punë sekondare; dukuria e vjedhjeve është shqetësim i vazhdueshëm, prandaj jemi duke punuar në preventivë në këtë drejtim, dhe shtoi se është një e metë që policia vazhdimisht po dëmtohet me vendimet e prokurorisë dhe gjykatave, duke përmendur rastin kur policia ka arrestuar një grup të hajnave nga Mitrovica që kanë operuar në Vushtri, kurse prokurori urdhëron që të lirohen në procedurë të rregullt, dhe kur lirohen të njëjtit brenda 7 minutave kryejnë vjedhjen tjetër serike. Në fund tha se qëllimi i tij si komandant stacioni është që ta bëjë përgjegjës secilin zyrtar policor karshi gradës dhe pozitës që e ka, dhe të njëjtit të jenë të pavarur në ushtrimin e autorizimeve policore.

3. Shqyrtimi i Informatës për pasqyrat financiare të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2013 (Drejtoria për Buxhet dhe Financa).

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - lidhur me informatën në fjalë, paraqiti këto pyetje: a ka përgatitur dhe a ka dorëzuar komuna raporte të rregullta tremujore në Ministrinë e Financave gjatë vitit 2013; a është saktësia dhe cilësia e informatave e prezantuar në raportin financiar sipas kërkesave financiare ligjore; a është përfshirë prezantimi i plotë i pagesave nga palët e treta në raportin vjetor financiar dhe a ka ndonjë mangësi informatash që i bën këto pasqyra të jenë jo të plota dhe jo të sakta; a është e plotë përmbledhja e pasurive jofinanciare (nga linjat e financimit të ministrive të ndryshme)?

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit - duke iu referuar informatës në fjalë, tha se në vazhdimësi autoriteti komunal pas çdo pasqyre të dhënë ka edhe komentet, e që në fakt nuk janë komente, por janë pasqyrim i shkurtë i pagesave. Pastaj tha se në këto pasqyra financiare nuk ka një analizë të mirëfilltë që me këtë buxhet të shpenzuar sa ka ndryshuar pozitivisht zhvillimi ekonomik i Komunës së Vushtrrisë, si dhe sa kanë përfituar qytetarët tonë prej këtyre shpenzimeve. Pastaj tek faqja 10, te shpenzimet e udhëtimit, ku janë rritur shpenzimet gati 100 % në këtë vit në raport me vitin 2012. Po ashtu te shënimi 10, në kuadër të shpenzimit të rrymës, a hyjnë edhe tri zyrat e

Ministrisë së Punëve të Brendshme, të cilat i shfrytëzon në ndërtesën e komunës, edhe për këtë kërkoi sqarim. Mandej faqe 13, shënimi 12 investimet kapitale kërkoi sqarim pse në pozicionet që janë numëruar nuk ka ndërtim të rrugëve; në faqe 15, shënimi 16 te detyrat vetanake, pozicioni të hyrat nga shitja e pasurisë, kërkoi sqarim çka ka shitur komuna në vitin 2013, dhe mbi çfarë baze ligjore; faqe 19 te detyrimet kontingjente, kërkoi sqarim se çka ka ndërmarrë qeveria komunale për këto obligime dhe që përgjegjësitë që i kanë shkaktuar të dalin para ligjit, me ç'rast kërkoi që të mos shpenzohet në këtë formë paraja publike e qytetarëve; te faqja 20 klasifikimi i pasurisë, te pozicioni "toka" tha se ka shtim (rritje) të vlerës së tokës për afro 42.000 € në raport me vitin 2012, prandaj pyeti se a ka blerë tokë komuna, kur e ka blerë dhe mbi çfarë baze ligjore, dhe shtoi se po në këtë shënim tek pozicioni "tjera" pyeti se cilat pasuri përfshihen në këtë pozicion? Në vazhdim lidhur me rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm, tha se në bazë të të dhënave që disponon, sekretarët e shkollave janë pa akte të emërimit, po ashtu pa akte të emërimit ka të punësuar edhe në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport. Në fund lidhur me këto pasqyra financiare, tha se ka qenë e nevojshme që të kemi një pasqyrë me këto shpenzime të buxhetit për ta kuptuar sesa e kemi përmirësuar zhvillimin ekonomik të komunës sonë me investime e bëra, prandaj konsideroi se ky buxhet nuk i ka kontribuar zhvillimit ekonomik, sepse ky buxhet ka qenë i asfalteve.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - duke iu referuar informatës në fjalë, tha se edhe më herët kanë kërkuar që këto pasqyra financiare të shoqërohen me komente, pasi që të njëjtat janë të përgatitura për institucione profesionale (për ministri). Pastaj lidhur me rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm, pyeti se a është përgatitur plan për realizimin e atyre rekomandimeve te Drejtoria për Buxhet dhe Financa, si dhe tek drejtoritë tjera, e sidomos çështja e rekomandimit për realizimin e të hyrave vetanake, pasi që dihet se ka pas rënie në inkasimin e të hyrave vetanake, si burim i rregullt dhe i përhershëm i komunës. Pastaj te faqja 14 kërkoi sqarime më të mëdha, pasi që ka reagime nga qytetarët tek ndarja e projekteve, sidomos tek lëmi i bujqësisë, sepse qytetarët shprehin shqetësime se ato nuk janë bërë në baza reale për ata që kanë potencial real për zhvillimin e bujqësisë, por me ndikime të ndryshme, prandaj kërkoi që të informohemi se kush janë përfituesit e këtyre projekteve. Në fund tha se është e nevojshme që të kemi një informatë të përgjithshme dhe të saktë, dhe në kuadër të saj të merren masa adekuate.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së - duke iu referuar vërejtjeve dhe pyetjeve të anëtarëve të KK-së lidhur me informatën në fjalë, u përgjigj me sa vijon: në bazë të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave, jemi të obliguar që të përgatitim raportet dhe t'i dorëzojmë në afat të caktuar kohor në Ministrinë e Financave; çdo shënim në çdo tabelë ka komentet në bazë të standardeve adekuate; sa i përket pasurisë, tha se është një ngecje lidhur me kompletimin e të dhënave, pasi që të gjitha donacionet nga palët e treta që kanë investuar në Komunën e Vushtrrisë, në mungesë të të dhënave dhe materialeve financiare nuk ka qenë e mundur të futen në sistem; sa i përket shpenzimeve të transportit ka ardhur si rezultat i përfshirjes së transportit të nxënësve, i cili në vitin 2013 ka pasur një kosto më të lartë; sa i përket shitjeve të aseteve, në këtë pozicion hyjnë të hyrat nga shëndetësia dhe arsimit; kur jemi te çështja e rekomandimit lidhur me aktet e emërimit, në këtë vit Drejtoria për Arsim i ka përgatitur aktet e emërimit për implementim; sa i përket hartimit të planit për implementimin e rekomandimeve, sqaroi se Drejtoria për Buxhet dhe Financa është në zbatim e sipër të planit në fjalë. Në fund tha se kjo është një informatë për të cilën nuk kërkohet votim, pasi që fjalën përfundimtare e jep Auditori i Përgjithshëm, sepse pasqyrat financiare janë të përgatitura në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik të parasë së gatshme, dhe shtoi se Komuna e Vushtrrisë tri vite radhazi ka fituar titullin më të lartë të auditimit, e që është titull i pakualifikuar.

Idriz Muzaqi, përgjegjës i Zyrës Ligjore - lidhur me detyrimet kontingjente, tha se këto janë detyrime të supozuara, kurse lidhur me punëtorët e Qendrës së Kulturës

“Hasan Prishtina”, sqaroi se nëse bëhet fjalë për performuesit e artit, ata nuk e kanë statusin e shërbyesit civil, por e kanë statusin e shërbyesve profesional dhe nuk i nënshtrohen aktit të emërimit, por kontratës së punës.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit – duke iu referuar hartimit të pasqyrave financiare sipas standardeve të kontabilitetit ndërkombëtar, tha se pasqyrat financiare të komunave tjera për vitin 2012, e kanë të precizuar pozicionin e ndërtimit të rrugëve, kurse DBF-ja në Vushtrri i ka përfshirë në pozicionin “të tjera”, duke shtuar se ndoshta komunat tjera kanë tjera standarde të kontabilitetit ndërkombëtar.

4. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë 2013/2014 (Drejtoria për Arsim).

Selvete Sholla, anëtare e kuvendit- tha se informata në fjalë është shumë e mangët, dhe shtoi se për nivelin e arsimit 3 është dhënë vetëm një tabelë me rezultate për të tri shkollat me arsim të mesëm të lartë, prandaj përveç kësaj tablele, është dashtë t'i bashkëngjiten edhe tri tabela ku do të paraqiteshin sukseset e ndara për tri shkollat e mesme. Pastaj pyeti pse nuk janë përfshirë në këtë informatë edhe problemet dhe parregullsitë që e kanë shoqëruar gjysmëvjetorin e parë. Në vazhdim tha se kërkon sqarime për këto çështje: sa janë të furnizuara shkollat me ujë të pijshëm; sa janë të furnizuara shkollat me lëndë djegëse, pasi që ka të dhëna se disa shkolla kanë lëndë djegëse edhe për 4-5 ditë; a do të merret parasysh furnizimi i shkollave teknike dhe profesionale me tekste shkollore nga Drejtoria për Arsim, kur dihet që për lëndët profesionale edhe sot ka mungesë të teksteve; çfarë do të ndërmerret për furnizimin e laboratorëve me materiale të nevojshme për punë praktike. Ndërsa lidhur me suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë, tha se askush prej nesh nuk është i kënaqur me rezultatin e suksesit në shkolla të mesme, e aq më pak nëse merret parasysh numri shumë i madh i mungesave, dhe shtoi se ky numër i mungesave vjen si pasojë se nxënësit nuk largohen prej shkollave për shkak të mungesave, dhe për këtë arsye Grupi kuvendar i LDK-së kërkon ndryshimin e Rregullores së shkollës, si dhe pyeti se çka do të ndërmerret Drejtoria për Arsim për të përmirësuar rezultatin në gjysmëvjetorin e dytë. Po ashtu tha se dukuri tjetër shqetësuese është edhe fakti që në fund të vitit shkollor 2012/2013 klasat e 5-ta në përqindje prej 53.28 % kanë kryer vitin me sukses të shkëlqyeshëm, kurse të njëjtit nxënës në klasat e 6-ta në përqindje prej 26.76 % janë me sukses të shkëlqyeshëm. Gjithashtu klasat e 9-ta në përqindje prej 38.33 % janë me sukses të shkëlqyeshëm, kurse të njëjtit nxënës që janë regjistruar në klasat e 10-ta vetëm 5.93 % janë me sukses të shkëlqyeshëm, prandaj ky rezultat po e vë në pikëpyetje vërtetësinë e vlerësimit të diturisë. Pastaj pyeti Drejtorinë për Arsim nëse do të hartojë një plan veprimi në mënyrë që të mos mbesin mësimdhënësit pa punë, pasi që dihet që në vitin e ardhshëm shkollat e mesme teknike dhe profesionale nuk do të kenë klasa të 13-ta. Pastaj kërkoi informatë me shkrim për mësimdhënësit që mbajnë kurse private me pagesë, dhe të njëjtit në bazë të shqetësimeve të nxënësve dhe prindërve, i kushtëzojnë me nota dhe anashkalohen në orët e mësimi. Në fund i sugjeroi Drejtorisë për Arsim që të shtojë masat e sigurisë në shkolla, e në veçanti në shkollat e mesme, si dhe kërkoi që të bëhet ndriçimi i rrugës prej vendit ku qëndrojnë punëtorët e sigurimit në shkollën e mesme profesionale e deri te shkolla teknike.

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit - tha se informatës në fjalë i mungojnë disa detaje, siç janë: notat mesatare nëpër shkolla; rezultatet e aktiviteteve (garave) të realizuara në mes të nxënësve. Pastaj kërkoi laboratorë dhe kabinetet të pajisen me mjete konkrete në gjimnazin “Eqrem Çabej”. Mandej në emër të Grupit kuvendar të AAK-së kërkoi që Drejtoria për Arsim ta ketë prioritet emërimin e shkollave, renovimin e shkollave, të cilat kanë nevojë për renovime. Në vazhdim tha se Drejtoria për Arsim duhet ta merr parasysh implementimin e iniciativës së Grupit të grave deputete nga mandati i kaluar, për kontrollimin sistematik shëndetësor të nxënësve. Pastaj propozoi që nëpër shkolla të inicohet pranimi i nga një psikologu, pasi që është në interesin e nxënësve, si dhe

kërkoi që të punohet më shumë me nxënësit që kanë ngecje në shkrim dhe lexim. Në fund njoftoi se oborri i shkollës "Nazmi Zhegrova" në fshatin Stanoc i Ulët është kthyer në deponi të mbeturinave, duke shtuar se nëse vërtetohet një gjendje e tillë, atëherë urgjentisht të merren masa.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit - ngriti çështjen e emërimit të shkollës në fshatin Sumë, pasi që emërtimi i shkollës ka mbetur i kontestueshëm, duke shtuar se para një kohe shkolla është emërtuar me emrin e Adem Vocës, por që një kohë të gjatë dikush e ka shlyer atë emër, dhe aktualisht shkolla në një farë mënyre ka mbetur e paemërtuar, prandaj pyeti se a është hulumtuar se kush e ka shlyer atë emër, pasi që emri i Adem Vocës duhet respektuar dhe çmuar pasi që ka merita të mëdha patriotike.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit - tha se informata në fjalë është dashtë të jetë më voluminoze për nga përmbajtja e saj. Pastaj kërkoi që të ndahet buxhet më i madh për Drejtorinë për Arsim, në mënyrë që të plotësohen mungesat e përmendura nga anëtarët e KK-së, siç janë çështja e furnizimit të laboratorëve me materiale të nevojshme, renovimet e shkollave, organizimi i sigurimit fizik të shkollave dhe mirëmbajtja e shkollave, duke propozuar që për këto çështje të planifikohen të hyra vetanake nga komuna.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - duke iu referuar informatës në fjalë, tha se hapësira e brendshme dhe e jashtme e shkollave, si dhe nyjet sanitare në pjesën dërrmuese të shkollave nuk funksionojnë, prandaj kërkoi që të merren masa në mënyrë të planifikuar, duke e vlerësuar gjendjen reale në terren. Po ashtu tha se duhet të merren masa që të ketë siguri të plotë në shkolla, duke kërkuar që në shkolla në vend të pranimit në punë të militantëve të ndryshëm, të punësohen njerëz që janë të nevojshëm për shkolla, siç janë pedagogët dhe psikologët.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - lidhur me informatën në fjalë, tha se në të kaluarën çdo fillim i vitit shkollor është shoqëruar me protesta për rritje të pagave, kurse gjatë këtyre viteve të qeverisjes së PDK-së, çdo vit shkollor fillon me organizime festive. Po ashtu tha se janë ndërtuar shumë shkolla, transporti i organizuar i nxënësve realizohet nga Komuna e Vushtrrisë dhe shtoi se në bazë të statistikave testi kombëtar i nxënësve ka shënuar ngritje, është rritur performanca e mësimnxënies dhe mësimdhënies, nxënësit e komunës tonë regjistrohen pa probleme nëpër fakultete.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit - lidhur me informatën në fjalë, tha se në KPF ka kërkuar që tabela për rezultatin e provimit të maturës të jetë shtojcë e këtij materiali, pasi që ka të bëjë me rezultatet e një viti shkollor paraprak. Pastaj tha se duhet të merren masa ndaj nxënësve që kanë bërë shumë mungesa në orët mësimore.

Izet Miftari, zyrtar nga DA-ja - lidhur me pyetjet dhe vërejtjet e anëtarëve të KK-së për informatën në fjalë, u përgjigj me sa vijon: kjo është vetëm një informatë dhe si e tillë nuk është raport për të qenë më voluminoze; gjatë një kontrollimi të përgjithshëm të shkollave nga policia nuk është gjetur asnjë gjë e ndaluar; në arsim është një rregull, ku arsimtarët përdorin tjetër kriter të vlerësimit në gjysmëvektorin e parë e tjetër në të dytin; në krahasim me vitin e kaluar shkollor, në këtë vit ka ngritje të suksesit; sukcesi i klasëve të 9-ta përpilohet në bazë të statistikave që sjellin shkollat në Drejtorinë për Arsim; gjatë viteve 2008-2013 janë ndërtuar 10 shkolla në territorin e Komunës së Vushtrrisë; emërtimi i shkollave duhet të inicohet nga këshilli i shkollës përkatëse; në këtë vit ka filluar renovimi gjeneral i dy shkollave; Drejtoria për Arsim nuk ka informacion se shkollës në Sumë iu është shlyer emri i Adem Vocës.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit - pyeti se si mund të jenë brenda një shkolle 85 nxënës të panotuar.

Izet Miftari, zyrtar nga DA-ja - duke iu referuar pyetjes së F.Hazirit, u përgjigj se Drejtoria për Arsim nuk mund të detyrojë nxënësit e shkollave të mesme të larta për të vazhduar procesin mësimor, pasi që ky lloj i arsimimit nuk është i obligueshëm.

5. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për përcaktimin e kritereve për sigurimin e strehimit për kategoritë sociale – shqyrtimi i parë (Drejtorja për Shëndetësi).

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit - duke iu referuar nenit 9 të draft-rregullores në fjalë, tha se do të duhej që kriteret të rangohen në kategori, pasi që janë keq të ranguara dhe poentomi i tyre do të ishte shumë i vështirë, prandaj për të njëjtat propozoi që të ndahen nëpër kategori sipas kësaj radhitjeje: statusi familjar; kushtet aktuale të banimit; prona dhe pasuria; gjendja e varshmërisë së rasteve; gjendja shëndetësore, ku mund të përfshihen të gjitha kategoritë tjera, të cilat nuk janë të përfshira, siç janë martirët, kurse tek pika 5 e nenit 9, tha se është dashtë të përmendet përqindja e invaliditetit, si dhe të sqarohet se një familje sa anëtarë i ka invalid. Te neni 16, pika 3, propozoi t'i shtohet edhe kjo fjali: "*në emër të prindit dhe të gjithë anëtarëve tjerë mbi moshën 18 vjeçare*", po ashtu të kërkohet edhe dëshmia se nuk posedon pronë dhe nuk ka përfituar nga ndonjë proces i rindërtimit, si dhe të shtohet dëshmia për kohëzgjatjen e banimit në qendrat kolektive të banimit (baraka). Në fund kërkoi që draft-rregullorja në fjalë të plotësohet me propozimet e paraqitura më lartë.

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit - lidhur me nenin 9 të draft-rregullores në fjalë, propozoi që ky nen të plotësohet me këto propozime: familjet e martirëve të lirisë me 5 pikë; familjet e të burgosurve politik me 4 pikë dhe familjet e veteranëve të UÇK-së me 5 pikë.

Myrvete Hetemi, anëtare e kuvendit - duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, tha se kjo draft-rregullore i ka disa probleme thelbësore, të cilat duhet trajtuar në mënyrë shumë më humane, e që nënkupton se kriteret e përcaktuara me pikë, të njëjtat janë fyese, sepse çdo rast social duhet trajtuar njësoj, prandaj kjo draft-rregullore duhet të ndryshojë në qasje, që nënkupton se përveç tek aspekti sasior i kriterëve, duhet të jetë edhe tregues empirik apo faktik përmes vizitave tek rastet përkatëse dhe raportet tjera nga sektori i shëndetësisë, arsimit dhe policisë, e që përmes këtyre raporteve të përcaktohet vendimi. Po ashtu kërkoi që çështja e patundshmërisë të mos ndërlihet me kriterin. Në fund tha se janë kundër kësaj forme të poentimit nga komisioni, pasi që kjo formë mundëson marrjen e vendimeve të padrejta dhe politike, ashtu siç veprohet edhe me punësime, ku poenat partiake e përzgjedhin të punësuarin.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Ipet në diskutim publik Draft-Rregullorja për përcaktimin e kriterëve për sigurimin e strehimit për kategoritë sociale në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Diskutimi publik fillon nga data 28.02.2014 dhe zgjatë deri më 20.03.2014.

6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale (Drejtorja për Shëndetësi).

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit - duke iu referuar pikës 31.4 të nenit 1 të propozim-vendimit në fjalë, tha se ka mbetur e paqartë si formulim, prandaj kërkoi që e njëjta të riformulohet. Po ashtu lidhur me nivelin e taksës për këtë vërtetim, në emër të Grupit kuvendar të LDK-së propozoi që te nenet 31.4 dhe 31.5 taksa të jetë 2.50 €, pasi që shumën prej 5.00 € është e lartë.

Abdullah Klinaku, drejtor i DSHPS-së- arsyetoi taksat e propozuara në propozim-vendimin në fjalë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 19 vota "për", 16 "kundër" vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim plotësohet "Rregullorja mbi tarifat, ngarkesat dhe gjocat komunale", gjegjësisht nenit 31 nga sfera e shëndetësisë dhe shërbimeve sociale – i shtohen edhe këto tarifa, përkatësisht shtohet pika:

31.4 Vërtetim që nuk ka detyrime financiare ndaj personave për ushqimin dhe mbajtjen (alimentacionin).....	5.00 €;
31.5 Certifikatë për zotësi veprimi.....	5.00 €.

7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e subvencioneve për klubet sportive (Drejtoria për Kulturë).

Syzana Sylja, anëtare e kuvendit - tha se nuk pajtohet me propozim-vendimin në fjalë, pasi që shpërndarja e mjeteve nuk është bërë në bazë të kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në Rregulloren për përcaktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për ndihmë momentale entiteteve publike dhe jopublike, prandaj kërkoi nga DKRS-ja që të sqarojë se cilat kriterë janë marrë për bazë gjatë hartimit të propozimit për shpërndarjen e mjeteve financiare për vitin 2014 për klubet sportive, duke shtuar se për klubet sportive të ligës së njëjtë nuk është bërë ndarje e barabartë e mjeteve, dhe për këtë arsye propozoi që të korrigohet shpërndarja e mjeteve financiare, duke iu ndarë shuma të njëjta klubeve sportive që janë në të njëjtën ligë.

Zoran Rakic, anëtar i kuvendit - duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, pyeti se pse nuk janë paraparë ndarje të mjeteve financiare për klubet sportive serbe, të cilat veprojnë në territorin e Komunës së Vushtrrisë, si dhe shtoi se klubet në fjalë kanë filluar regjistrimin e tyre në përputhje me ligjet e Kosovës, prandaj pyeti se pas regjistrimit të tyre, a mund të parashihet ndarja e mjeteve financiare edhe për këto klube.

Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit - lidhur me propozim-vendimin në fjalë, propozoi që klubet sportive të rangohen në bazë të pozitive që i kanë në ligë, si dhe më shumë subvencione të ndahen për klubet që janë në superligë.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit - tha se ndarja e subvencioneve të paraqitura në propozim-vendimin në fjalë është bërë mbi bazën e kriterëve të duhura, prandaj të njëjtën e përkrah Grupi kuvendar i Vetëvendosjes. Po ashtu kërkoi që të monitorohet shpenzimi i këtyre mjeteve, në mënyrë që të përfitojnë sa më shumë sportistët, e jo të keqpërdoren nga zyrtarët e klubeve sportive për qëllime tjera. Në fund kërkoi që të ketë përkrahje të veçantë nga Kuvendi komunal dhe nga komuna për klubet sportive që pretendojnë titullin e kampionit dhe paraqitje në arenat ndërkombëtare.

Shpresa Rama, drejtoreshë e DKRS-së - duke iu referuar vërejtjeve dhe pyetjeve të anëtarëve të KK-së lidhur me propozimin-vendimin në fjalë, u përgjigj me sa vijon: për ndarjen e mjeteve financiare për klubet sportive, DKRS-ja ka marrë për bazë këto kriterë: liga në të cilën garojnë; nëse është grup apo garues individual; lloji i ekipit. Pastaj tha se nëse ka klube sportive serbe të regjistruara që veprojnë brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë, dhe të njëjtat paraqesin kërkesë për subvencionim, atëherë do të trajtohen në mënyrë të barabartë sikur të gjitha klubet tjera sportive.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - tha se Kuvendi i komunës edhe më herët ka përkrahur subvencionimin e klubeve sportive, por kriteret e ndarjes në momente të caktuara po ndryshojnë. Pastaj tha se është shumë më mirë që të ketë të rinj të shëndoshë të mbledhur në klube sportive, sesa të mbesin anash nëpër rrugë dhe nëpër kafene, e që mund të kryejnë sjellje devijuese. Mandej tha se në propozim-vendimin në fjalë nuk është marrë për bazë parimi i kualitetit dhe masovitetit. Po ashtu kërkoi që të shqyrtohen njësoj kërkesat e klubeve sportive të nivelit të njëjtë garues. Në fund kërkoi që klubet sportive që mund të na përfaqësojnë në arenën ndërkombëtare të ndihmohen me mjete financiare edhe përmes ribalancit për plotësimin e nevojave të tyre, për një përfaqësim sa më dinjitoz.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 25 vota "për", të tjerat "abstenim" vendosi me sa vijon:
 Me këtë vendim, mjetet buxhetore të komunës - fondi për transfere dhe subvencione, për vitin 2014, në shumën prej 35.000 € (për klube sportive) ndahen si më poshtë:

• KF "Llamkos Kosova"	6.000 €;
• KF "Artakolli"	2.500 €;
• KF "Vicianum"	1.300 €;
• KH "Kosova" (F)	3.000 €;
• KH "Kosova" (M)	3.000 €;
• KH "Samadrexha" (F+M)	4.600 €;
• KBB "Kosova"	2.200 €;
• KBB "Vushtrria" Basket	1.000 €;
• KV "As Vushtrria"	1.300 €;
• KV "Gjimnazisti"	1.000 €;
• KV "Kosova" (F)	1.200 €;
• K. Kickboxit "Kosova"	1.200 €;
• K. Kickboxit "UKA"	300 €;
• KB "Kosova"	800 €;
• KM "Kosova"	500 €;
• KGJ "Kosova"	300 €;
• KSH "Ura e Gurit"	400 €;
• KSH "Llamkos"	600 €;
• KSH "Shqiponja"	800 €;
• KPP "Hasan Prishtina"	500 €;
• Shoqata e të shurdhërve	300 €;
• SHP "Sitnica"	300 €;
• Shoqata e Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit Shkollor	300 €;
• Tifozeria "FORCA"	1.000 €;
• K. BODIB. "MIC SOKOLI"	300 €;
• Muhamet Rama	300 €;

Gjithsej35.000 €.

8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale (Drejtoria për Kulturë).

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit - lidhur me propozim-vendimin në fjalë, tha se pagesat e tarifave duhet të bëhen vetëm nga institucionet dhe individët, të cilët përfitojnë financiarisht nga shfrytëzimi i hapësirave publike, kurse duhet të lirohen nga këto pagesa të gjitha kategoritë që nuk kanë mundësi ta paguajnë një gjë të tillë. Pastaj tha se është kundër tarifave për shfrytëzimin e palestrave sportive dhe hapësirave tjera publike, pasi që kjo e ngulfat zhvillimin e aktiviteteve të lira, dhe e njëjta është mendësi e biznesit, e jo e institucionit publik.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit - tha se disa kategori të lexuesve kanë qenë të liruar nga pagesa, prandaj pyeti se të njëjtit a janë përsëri të liruar nga pagesa?

Shpresa Rama, drejtoreshë e DKRS-së - sqaroi se përsëri janë të liruar nga pagesa lexuesit që bëjnë pjesë në kategori të veçanta shoqërore.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit - tha se nxënësit që i shfrytëzojnë bibliotekat e shkollave nuk duhet obliguar që të paguajnë shfrytëzimin e tyre, kurse pagesa bëhet nga nxënësit vetëm nëse i shfrytëzojnë librat nga biblioteka e qytetit.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 22 vota "për", 10 "kundër", 3 "abstenim" vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale 01Nr. 333/12 dt.27122012 në nenin 34 dhe 35 me sa vijon:

Neni 34 i rregullores bazë ndryshohet dhe plotësohet si vijon:

Ndryshim i pikës a dhe b

- a) Një orë e organizimit dhe tubimeve të ndryshme pa zërim, pa dekor, por me ngrohje (gjatë dimrit) 50.00€, paushall 100.00 €;
- b) Një orë e organizimit dhe tubimeve të ndryshme me zërim, dekor (materiali i organizatorit, puna kryhet nga stafi), ngrohje (gjatë dimrit) 100.00 €, paushall 200.00 €.

Alineja 34.1. Tarifa për anëtarësim në bibliotekën e qytetit "Naim Frashëri"

- a) Pagesa për anëtarësi për lexues (nxënës) të shkollave fillore.....1 €;
- b) Pagesa për anëtarësi për lexues (nxënës) të shkollave të mesme, studentë dhe të tjerë.....2 €;
- c) Pagesa bëhet njëherë në vit. Punëtori i autorizuar në bibliotekë i evidenton pagesat me bllok-serik;
- d) Për një libër të humbur apo të dëmtuar skajshmërisht, lexuesit e të gjitha kategorive detyrohen ta bljenë atë libër dhe ta sjellin në bibliotekë;
- e) Prej pagesës së anëtarësisë në bibliotekën e qytetit "Naim Frashëri" lirohen të gjithë anëtarët e familjeve të dëshmorëve, veteranëve, invalidëve të luftës dhe martirëve.

Alineja 34.2. Tarifat arkivore

- a. Kërkesa për lëshuarjen e dëshmive nga lënda arkivore1 €;
- b. Lëshuarja e certifikates/vërtetimit që nuk është liruar nga procedura e taksave për certifikatë/vërtetim.3 €;
- c. Lëshuarja e certifikatave të liruara nga pagesat sipas dispozitave ligjore të shërbimit publik-civil (familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës),pa pagesë;
- ç. Fotokopjimi i dokumenteve:

- për punë shkencore

- një faqe A-4.....0,10 €;
- një faqe A-3.....0,20 €;
- një faqe A-O1 €.

- për çështjet private të rregullimit të të drejtave civilo-juridike:

- një faqe A-4.....1 €;
- një faqe A-31,5 €;

- një faqe A-03 €.
- për institucione publike/private:
 - një faqe A-4 2 €;
 - një faqe A-3 3 €;
 - një faqe A-0 5 €.
- për organizata humanitare dhe pensionistë:
 - një faqe A-40,10 €;
 - një faqe A-30,20 €;
 - një faqe A-00,50 €.
- d. Skanimi-digjitalizimi i dokumenteve:**
 - një faqe A-40,40 €;
 - një faqe A-30,70 €.
- e. Shtypja e dokumentetit (aty ku nuk është i mundur kopjimi):**
 - një faqe0,50 €;
- f. Shfrytëzimi i projekteve, me procedurë të veçantë të sigurimit, me përcjellje të punëtorit arkivor, për një ditë30 €;**
- g. Rregjistrimi në regjistrator i lëndës arkivore me të gjitha operacionet përkatëse të valorizimit, inventarizimit, etj., për një metër gjatësi (varësisht prej gjendjes së lëndës arkivore)10-30 €;**
- h. Përpilimi i listave të kategorive të dokumentacionit arkivor me afate të ruajtjes, për një faqe5 €;**
- i. Dhënia e ndihmës profesionale institucioneve jashtë planit të arkivit me kërkesë të poseduesit, për një orë.....20 €;**
- j. Pagesa e një eksperti të arkivit në ligjërata në institucion, me kërkesë të tyre, për një ligjërata.....100 €;**
- k. Përgatitja e materialit profesional për menaxhim zyrtar e arkivor, të institucionit/organizatës, për një faqe5 €;**
- l. Përgatitja e një kutie arkivore për fonde-krijuese, sipas kërkesës së tyre.....5 €;**
- m. Digjitalizimi i mikrofilmave për nevoja shkencore, për një mikrokuadër të digjitalizuar0,10€;**
- n. Printimi i një faqeje nga kompjuteri, i dokumenteve të digjitalizuara.....0,10 €;**
- o. Dorëzimi i dokumentacionit në formë digjitale.....0,05 € + CD 1 €.**

Neni 35 i rregullores bazë ndryshohet dhe plotësohet si vijon:

Plotësim i nenit 35.1 në pikën e, f:

e. Ndashjet sportive me bileta mbi 400 shikues:20% nga shitja e biletave;

f. Për 90 min. stërvitje për klubet sportive private:

-me ndriçim.....14.00€;
-pa ndriçim.....12.00€.

Alineja -35.2 Nga pagesat e përmendura në nenin 35.1, 36.1 dhe 36.2, të rregullores në fjalë, lirohen nga pagesa të gjitha klubet sportive të komunës dhe shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së, dega në Vushtrri, si dhe televizionet për incizimin e ngjarjeve sportive.

Alineja -35.3 pika h: Nga pagesat e përmendura të nenit 35.3 të kësaj rregulloreje, lirohen: shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së (të Komunës së Vushtrrisë), për dy termine brenda javës; shoqata "HANDIKOS" për një termin brenda javës; manifestimet dhe tubimet e organizuara nga ana e Komunës së Vushtrrisë; SHPKF dhe SSH për organizimin dhe mbajtjen e garave shkollore në nivel komunal, regjional dhe republikan; SHPK; bashkësitë; shoqatat dhe organizatat e ndryshme jofitimprurëse, të cilat veprojnë në Komunën e Vushtrrisë.

Plotësim të nenit 35.3 në pikën i.

i. Shfrytëzimi i Palestrës sportive, për tubime dhe organizime të ndryshme pa zërim dhe dekor:

-60 min. 80.00€;
-paushall..... 150.00€.

Neni 36 i rregullores bazë ndryshohet dhe plotësohet si vijon:

Alineja 36.1 pika c

c) Për një orë rekreacion:

- me ndriçim.....8.00 €;
- pa ndriçim.....4.00 €.

Alineja 36.2 pika b dhe c

b) Për 90 min. stërvitje për klubet sportive private:

- me ndriçim..... 6.00 €;
- pa
ndriçim.....3.00 €.

c) Për 60 min. rekreacion:

- me ndriçim..... 4.00 €;
- pa ndriçim.....2.00 €.

9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shfuqizim të Rregullores për procedurat e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale (Zyra Ligjore).

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit - duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, tha se Grupi kuvendar i LDK-së për mbledhjen e ardhshme të KK-së kërkon informatë për të gjithë shfrytëzuesit e pronës komunale gjatë vitit 2013, për periudhën sa e kanë shfrytëzuar dhe e kanë në shfrytëzim, si dhe sa kanë paguar.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim shfuqizohet Rregullorja për procedurat e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale 01.Nr.19/1, të datës 31.01.2013.

10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale (Zyra Ligjore).

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - nga PDK-ja, propozoi për anëtar të komisionit në fjalë Isa Hajrizin.

Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit - duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, propozoi që në bazë të dispozitave ligjore, ky komision të ketë kompetencë edhe për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër edhe afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit - nga LDK-ja, propozoi për anëtar të komisionit në fjalë Agim Bregajn.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit - nga AAK-ja, propozoi për anëtar të komisionit në fjalë Rrahim Ajetin.

Enver Morina, zyrtar nga Zyra Ligjore - duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, kërkoi që të fshihet fjala "afatshkurtër".

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit - nga shoqëria civile propozoi për anëtar të komisionit në fjalë Isak Hysenin.

Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit - nga shoqëria civile propozoi për anëtar të komisionit në fjalë Zenel Bunjakun.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 31 vota "për" 4 "abstenim" vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim formohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme

komunale, në këtë përbërje:

Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit (PDK);

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit (LDK);

Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit (AAK);

Tefik Maloku, agronom;

Ramiz Maliqi, arkitekt;

Hyda Dallku, jurist;

Isak Hyseni, ekspert nga shoqëria civile.

11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit për ankesa lidhur me dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale (Zyra Ligjore).

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit - nga PDK-ja, propozoi për anëtar të komisionit në fjalë Ilmi Azemin.

Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit - nga LDK-ja, propozoi për anëtare të komisionit në fjalë Fatime Hazirin.

Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit - nga AAK-ja, propozoi për anëtar të komisionit në fjalë Muharrem Shabanin.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit - nga LVV-ja, propozoi për anëtar të komisionit në fjalë Ali Januzin.

Dibran Përçuku, nënkryetar i komunës - nga Zyra Ligjor, e për anëtar të komisionit në fjalë propozoi Enver Morinën.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim formohet Komisioni për ankesat e palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme komunale, në këtë përbërje:

Ilmi Azemi (PDK);

Fatime Haziri (LDK);

Muharrem Shabani (AAK);

Ali Januzi (LVV);

Enver Morina (Zyra Ligjore).

12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin e Vendimit Nr. 25/14, dt. 30.01.2014.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se në KPF nuk është diskutuar lidhur me bartjen e këtyre mjeteve, por pasi që është në interesin e komunës dhe qytetarëve për të mos u vonuar projektet që janë në realizim e sipër, propozoi që të aprovohet si i tillë për t'u mundësuar bartja e mjeteve në fjalë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim ndryshohet Vendimi nr.25/14, dt. 30.01.2014, përkatësisht paragrafët 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 ndryshohen shumatat e tyre, si vijon:

- *Shuma e mjeteve në kategorinë e pagave dhe mëditjeve (kodi 111), në shumën prej 1,397.24 €;*
- *Shuma e mjeteve të bartura në kategorinë – mallra dhe shërbime (kodi 130), në shumën prej 27,654.33 €;*
- *Shuma e mjeteve të bartura në kategorinë – subvencione dhe transfere (kodi 200), në shumën prej 3,530.55 € (prej kësaj shume 1,530.55 € barten në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, kurse shuma prej 2,000.00 € barten në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport për OVL-në e UÇK-së);*
- *Shuma e mjeteve të bartura në kategorinë – shpenzimet kapitale (kodi 300), në shumën prej 384,689.38€.*

Gjithsej 417,271.50€.

13. Të ndryshme:

a. Shqyrtimi i propozimeve për delegatët për Kuvendin Zgjedhor të Asociacionit të Komunave të Kosovës;

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - nga PDK-ja, për delegat të Kuvendit Zgjedhor të Asociacionit në fjalë propozoi Qerim Selimin.

Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit - nga AAK-ja, për delegat të Kuvendit Zgjedhor të Asociacionit në fjalë propozoi Mentor Ferizin.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- nga LDK-ja, për delegate të Kuvendit Zgjedhor të Asociacionit në fjalë propozoi Selvete Shollën.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 30 vota "për", 5 "abstenim" vendosi me sa vijon:

Aprovohet lista e delegatëve nga Komuna e Vushtrrisë për Kuvendin Zgjedhor të Asociacionit të Komunave të Kosovës, në këtë përbërje:

Bajram Mulaku (Kryetar i Komunës);

Qerim Selimi (anëtar i KK-së-PDK);

Selvetë Sholla (anëtare e KK-së-LDK);

Mentor Ferizi (anëtar i KK-së-AAK).

b. Shqyrtimi i propozimeve të AAK-së për dy komitetet obligative;

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit - për anëtare të KPF-së nga AAK-ja propozoi Bahrije Pllanën, kurse për anëtar të Komitetit për Komunitete propozoi Sabri Feratin.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 31 vota "për", 1 "kundër", 3 "abstenim" vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim plotësohet Vendimi nr. 22/14, dt. 30.01.2014, për emërimin e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF-së) me anëtarin e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë: Bahrije Pllana (AAK).

Me këtë vendim plotësohet Vendimi nr. 23/14, dt. 30.01.2014, për emërimin e anëtarëve të Komitetit për Komunitete me anëtarin e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë: Sabri Ferati (AAK).

c. Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit - për mbledhjen e radhës së KK-së kërkoi një informatë me shkrim lidhur me ndarjen e bursave për studentët për vitin 2013 në Komunën e Vushtrrisë, duke përfshirë të dhënat personale për përfituesit e këtyre bursave (emrin mbiemrin, emrin e prindit drejtimin në të cilin studiojnë, notën mesatare të përfituesit të bursës dhe drejtimin e studimeve).

Ali Januzi, anëtar i kuvendit - kërkoi informatë me shkrim për pretendimet se shoqëria kulturo-artistike "Hasan Prishtina" do të shuhet, prandaj kërkoi të informohet me shkrim për pretendimet në fjalë. Në vazhdim shtoi se në vitet e 80-ta nëpër shumë bashkësi lokale kanë ekzistuar shoqëri kulturo-artistike, por pas këtyre viteve ato janë shkatërruar, prandaj pyeti pse sot nëpër fshatrat tona nuk merret iniciativë për formimin e tyre. Po ashtu kërkoi informatë me shkrim lidhur me gjendjen e Shtëpisë së Kulturës "Hasan Prishtina" pasi që shumë po përflitet, dhe nuk po dihet se kjo ndërtesë a do të rrënohet apo do të rinovohet.

Myrvete Hetemi, anëtare e kuvendit - njoftoi se është zgjedhur Grupi i Grave Asambleiste me këtë strukturë udhëheqëse: Melihate Basholli-kryetare, Fatime Haziri-nënkryetare e parë, Bahrije Pllana-nënkryetare e dytë, Myrvete Hetemi-zëdhënëse.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit - ngriti shqetësimin lidhur me skandalet e konkurseve në komunën tonë, ku tha se një gjendje e tillë është duke na përcjellur që nga fushata e fundit zgjedhore, duke përmendur rastin konkret kur është shpallur konkursi për lëndën "Edukatë qytetare" në shkollën e Stanocit, por drejtori i Drejtorisë për Arsim ka transferuar një punëtor nga shkolla e Pantinës, prandaj pyeti se me çfarë baze lidhore ka ndodhur transferimi, pasi që punëtorja në fjalë është juriste, e nuk ka kualifikim adekuat për ligjërimin e asaj lënde. Pastaj skandali tjetër është konkursi i shpallur për vendet e punës në

administratën e komunës, ku me këtë konkurs janë akomoduar disa militantë nga subjekti politik i kryetarit të komunës, duke i përcaktuar kriteret e vlerësimit sipas dëshirës së tij, prandaj pyeti me çfarë baze ligjore ka vepruar në një mënyrë të tillë, duke e mbyllur pozitën “zyrtar për kulturë”, të shpallur më parë në konkurs. Në fund tha se nuk mund të shuhet shoqëria kulturo-artistike “Hasan Prishtina” pa vendim të Kuvendit të komunës.

Ergin Sunguri, anëtar i kuvendit - tha se në Zyrën për Kthim dhe Komunitete nuk ka vetëm përfaqësues nga komuniteti turk, prandaj pyeti pse nuk ka, duke shtuar se edhe ata kanë të drejtë ta kenë përfaqësuesin e tyre në këtë zyrë. Në fund kërkoi që materialet për anëtarët e kuvendit të dërgohen në kopje fizike.


Qerim Selimi, anëtar i kuvendit - duke iu referuar konkursit për shkollën e Stanocit, paraqiti sqarime shtesë lidhur me ecurinë e atij konkursi. Po ashtu kërkoi që materiali për mbledhjet e KK-së t’iu dërgohet në kopje fizike.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit - në emër të Grupit kuvendar të LDK-së përkrah fuqishëm ekzistencën e ansamblit “Hasan Prishtina”, dhe tha se në asnjë rrethanë nuk pranojmë që i njëjti të shuhet.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit - duke iu referuar diskutimeve nga disa anëtarë të kuvendit, tha se është absurde të diskutohet për shuarjen e një ansambli, i cili është pasqyrë e kulturës sonë qytetare.

Mbledhja përfundoi në orën 15:05.

Procesmbajtësi:


Alban Tahiraj

Lekturoi:


Vlora Krasniqi

Kryesuesi i Kuvendit:


Shpëtim Zhegrova